

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne: Date / Dana 191 0612025		
Nr. Orgv Org. jed 01	Nr. Prot Bt. Prot 160	Nr. Faqeve. Br. Strana 8
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## Procesverbal

Data e mbajtjes: 16/06/2025

Nga diskutimi publik për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Draft Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Regjionin e Ferizajt dhe Gjilanit

Në këtë takim morën pjesë:

- Alberton Sahiti, Drejtor i Sherbimeve Publike dhe Emergjencë,
- Alban Bajrami, Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave,
- Ilir Shabani Zyrtar i Lartë për Ambient, Kryesuese e Komisionit për Buxhetim me Pjesëmarrje,
- Qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## Hyrje nga përfaqësuesit komunalë:

### Fjala hyrëse e zyrtarëve komunalë:

Të nderuar qytetarë, përfaqësues të komunave dhe pjesëmarrës të pranishëm,  
Ju faleminderit që jeni këtu sot për të diskutuar – menaxhimin e mbeturinave në komunën e Ferizajt.

Dokumenti që po paraqesim është një studim dhe plan veprimi që synon të përmirësojë mënyrën se si i trajtojmë mbeturinat në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Ai është përgatitur me mbështetje nga organizata ndërkombëtare si GIZ dhe City Climate Gap Fund, dhe është hartuar në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e komunave.

Qëllimi është i qartë: më pak mbeturina, më shumë riciklim, dhe një mjedis më i pastër e më i sigurt për të gjithë. Plani propozon që komunat të bashkëpunojnë më ngushtë, të investojnë në sisteme moderne dhe të përfshijnë qytetarët në këtë proces.

Sot jemi këtu për ta ndarë këtë plan me ju – jo vetëm për t'ju informuar, por për t'ju dëgjuar. Mendimi juaj është thelbësor për të ndërtuar një zgjidhje që funksionon në praktikë dhe i shërben të gjithë komunitetit.

---

## Pikat kryesore të prezantuara nga drejtorja:

1. Parashikimi i gjenerimit të mbeturinave dhe objektivat deri më 2035:
  - 1.1. Mbulim 100% i popullsisë me shërbime të grumbullimit.
  - 1.2. Riciklim mbi 50% deri më 2030.
  - 1.3. Reduktim i mbeturinave që dërgohen në deponi.
  - 1.4. Krijimi i infrastrukturës për TMB, TA dhe kompostim.
2. Analiza e opsioneve dhe sistemi i preferuar:
  - 2.1. Zgjidhja rajonale është më efikase dhe ekonomike.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- 2.2. Ndërtimi i një impianti të përbashkët TMB me kapacitet 65,000 ton/vit.
- 2.3. Objekte kompostimi në Ferizaj dhe Gjilan.
- 2.4. Qendra riciklimi urbane dhe sisteme për ndarjen në burim.
- 2.5. Dy qendra ORM dhe skema të avancuara për mbetje të veçanta.
3. Ndërgjegjësimi publik dhe ndërhyrjet ligjore:
  - 3.1. Fushata vetëdijësuese për ndarjen në burim, kompostim dhe ndalimin e deponive ilegale.
  - 3.2. Mbyllja e deponive ilegale dhe vendosja e tarifave progresive.
  - 3.3. Përfshirja e sektorit privat në zbatim dhe monitorim.
4. Plani i Veprimit:
  - 4.1. Adresimi i deponive ilegale dhe zgjerimi i mbulimit të shërbimeve.
  - 4.2. Ndërtimi i infrastrukturës së riciklimit dhe trajtimit.
  - 4.3. Edukimi dhe përfshirja e komunitetit.
5. Partneriteti ndërkomunal dhe qeverisja:
  - 5.1. Marrëveshja ndërkomunale për ndarjen e rolit dhe operimin e përbashkët.
  - 5.2. Krijimi i komiteteve drejtuese dhe ndjekja e performancës.
  - 5.3. Përdorimi më efikas i resurseve dhe ulja e kostove për komunat.
6. Transformimi i kompanive ekzistuese:
  - 6.1. "Eco-Higjiena" dhe "Pastërtia" do të transformohen në operatorë të avancuar.
  - 6.2. Menaxhimi i impianteve, grumbullimi i ndarë, edukimi dhe digjitalizimi.
7. Digjitalizimi dhe ngritja e kapaciteteve:
  - 7.1. Monitorimi në kohë reale i rrjedhës së mbeturinave, tarifave dhe ankesave.
  - 7.2. Faturim elektronik dhe transparencë më e lartë.
8. Edukimi i publikut dhe ndryshimi i sjelljeve:
  - 8.1. Fushata për ndarjen në burim dhe përfshirja e shkollave.
  - 8.2. Trajnime për komunitetin dhe sektorin privat.
  - 8.3. Mbetjet si burim ekonomik, jo vetëm si mbetje.
9. Zhvillimi i infrastrukturës:
  - 9.1. Ndërtimi i impianteve për kompostim, TMB dhe trajtim anaerobik.
  - 9.2. Qendra riciklimi në qytetet kryesore.

Hyrje dhe Qëllimi i Planit:



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Plani Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) është një dokument strategjik i hartuar për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Partesh, Klllokot, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit dhe Shtërpçë. Qëllimi i tij është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe efikas për menaxhimin e mbeturinave.

Plani fokusohet në të gjitha fazat e ciklit të mbeturinave: nga grumbullimi, përpunimi, trajtimi, riciklimi e deri te asgjësimi final në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane mjedisore.

Paralelisht, Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) siguron që efektet mjedisore të planit të analizohen dhe të integrohen në vendimmarrje, në mënyrë që zbatimi i PNMIM të mos dëmtojë komponentët e ndjeshëm mjedisorë dhe të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm.

Gjendja aktuale mjedisore dhe sfidat-Sistemi ekzistues i menaxhimit të mbeturinave:Në shumicën e komunave rurale mungon një sistem i organizuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave. Vetëm qytetet kryesore si Gjilani dhe Ferizaj kanë struktura më të zhvilluara. Sidoqoftë, mungesa e riciklimit të organizuar, deponitë e improvizuara, mbledhja e rrallë e mbeturinave dhe mungesa e ndarjes në burim përbëjnë probleme serioze.

Qëllimet dhe Masat Kryesore të PNMIM:Plani parashih krijimin e një rrjeti të integruar infrastrukturor për menaxhimin e mbeturinave që përfshin:

- Përmirësimin e deponisë rajonale në Velekincë, që do të ketë kapacitet 126,200 ton/vit për 20 vjet.
- Ndërtimin e dy impianteve për riciklim (MRF Fabrika e Riciklimit të Materialeve): një në Gjilan (16,000 ton/vit) dhe një në Ferizaj (18,000 ton/vit).
- Dy objekte për kompostim për mbeturinat e gjelbra në secilin rajon me kapacitet 4,000 ton/vit.
- Një impiant të trajtimit mekaniko-biologjik (MBT) me kapacitet 65,000 ton/vit, për përpunimin e mbeturinave të përziera.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Një impiant për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan, si dhe impiante më të vogla në Kaçanik dhe Nerodime.
- Stacione transferimi të përmirësuara, me infrastrukturë për ngjeshjen dhe transportin efikas të mbeturinave.

---

#### Vlerësimi Mjedisor i Masave

Masat e propozuara u vlerësuan sipas një metodologjie të qartë të VSM-së. Vlerësimi përfshinte ndikimet në:

- cilësinë e ajrit,
- ujërat nëntokësorë dhe sipërfaqësorë,
- biodiversitet,
- tokën bujqësore dhe natyrën,
- ndryshimet klimatike,
- shëndetin publik.

#### Përfitimet Kryesore të Zbatimit të PNMIM

1. Reduktim i mbeturinave në natyrë dhe eliminim i deponive ilegale.
2. Përmirësim i shëndetit publik përmes eliminimit të djegieve të hapura dhe përpunimit të sigurt të mbeturinave.
3. Përfitime klimatike përmes reduktimit të metanit nga deponitë dhe promovimit të energjisë nga mbeturinat.
4. Zhvillim i ekonomisë qarkore – krijimi i vendeve të punës në sektorin e riciklimit dhe përpunimit.
5. Harmoni me legjislacionin e BE-së dhe strategjitë kombëtare si SKMIM dhe MSA.

---

Pjesëmarrja e Palëve të Interesuara



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

PNMIM dhe VSM janë zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse ku:

- Komunitetet lokale kanë dhënë komente dhe sugjerime;
- OJQ-të mjedisore dhe ekspertët teknikë kanë kontribuar në identifikimin e rreziqeve;
- Institucionet qendrore dhe komunale kanë bashkëpunuar ngushtë me konsulentët e GIZ dhe ESS Environmental Consulting.

---

Rekomandime për zbatim dhe monitorim

Raporti propozon që:

- Vendndodhjet për objektet e reja të përzgjidhen përmes studimeve të VNM dhe konsultimeve të mëtejshme.
- Të zhvillohen plane komunale të riciklimit, edukimit publik dhe mbështetje për sektorin formal/informal të grumbulluesve të mbeturinave.
- Të sigurohet financim i qëndrueshëm për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të reja.
- Të zbatohet një sistem i monitorimit të përhershëm mbi ndikimet mjedisore dhe performancën e objektivave të planit.

---

**PYETJET E QYTETARËVE GJATË DISKUTIMIT PUBLIK:**

- Pyetje: Një kompani private është shprehur e interesuar për të investuar në ndërtimin e një qendre për riciklim të mbeturinave. A mund të realizohet ky investim përmes komunës?
- Përgjigje: Zyrtarët sqaruan se për çdo investim të tillë është e nevojshme të pajiset me leje përkatëse nga niveli qendror, përkatësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Pyetje: A mund të hapet një gropë për të hedhur mbeturinat në mënyrë të thjeshtë për shkak të mungesës së infrastrukturës së riciklimit?
- Përgjigje: Zyrtarët theksuan se kjo nuk është një zgjidhje e qëndrueshme, pasi varrosja e mbeturinave pa masa mbrojtëse mund të çojë në ndotje të tokës dhe ujërave nëntokësore. Qasja e planifikuar është riciklimi dhe trajtimi modern.
- Pyetje: Si do të përfshihen qytetarët në ndarjen e mbeturinave në burim?
- Përgjigje: Zyrtarët komunale informuan se janë planifikuar fushata edukative dhe informuese për qytetarët për të promovuar ndarjen në burim dhe zvogëlimin e mbeturinave të padobishme.
- Pyetje: A parashihen masa për mbylljen e deponive ilegale?
- Përgjigje: Po, plani përfshin si objektiv prioritar identifikimin dhe mbylljen e të gjitha deponive ilegale në territorin e komunave përkatëse.
- Pyetje: A do të ketë subvencione për qytetarët për pajisje riciklimi ose për pagesa më të ulëta për menaxhimin e mbeturinave?
- Përgjigje: Zyrtarët sqaruan se aktualisht janë duke u shqyrtuar mundësitë për skema subvencionimi në bashkëpunim me donatorë dhe me ministritë përkatëse, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta.

## KONKLuzion:

Plani i prezantuar ofron një vizion afatgjatë për menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshëm të mbeturinave në rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Diskutimi publik theksoi rëndësinë e përfshirjes së qytetarëve, transparencës, ndërveprimit institucional dhe mbështetjes ndërkombëtare për zbatim sa më efikas.

PNMIM për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt paraqet një hap kyç drejt një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Ai përmban masa konkrete dhe të realizueshme që do



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e mjedisit, do të reduktojnë ndotjen dhe do të kontribuojnë në mirëqenien sociale dhe shëndetësore të banorëve.

Vlerësimi Strategjik Mjedisor konfirmon që ky plan është teknikisht i qëndrueshëm, mjedisërisht i sigurt dhe socialisht i pranueshëm